



Datë: 22.04.2026

A.nr.205/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi, dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.205/2026, të datës 25.02.2026, të parashtruar nga ankuesja: V.Sh, kundër organit të punësimit: Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 22.04.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.205/2026, e datës 25.02.2026, e parashtruar nga ankuesja V.Sh.

II. Detyrohet Kryeshefi Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë shqyrtimin e kërkesës së datës 12.01.2026, të parashtruar nga ankuesja e lartshënuar dhe të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja V.Sh (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesja), më datë 25.02.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Përgjigjes në shkresat zyrtare të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë me numër AKF/2026-013, të datës 28.01.2026, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së dispozitave materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.03.2026, ka proceduar

kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Kosovare për Forenzik, ndërsa, kjo e fundit më datë 05.03.2026, ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokoli 993/2026, të datës 25.02.2026, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin e parashtrimit të ankesës, të datës 25.02.2026; Kërkesën për përgjigje në ankesë 02.03.2026; Kërkesë e datës 12.01.2026; Përgjigje në shkresën me nr.AKF/2026-003, të datës 28.01.2026; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil, të datës 10.03.2025; Formularët për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesionale, të datës 20.01.2021 deri më 19.01.2024; Formularët e vlerësimit të punës të datës 19.01.2011 deri më 08.01.2019; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses V.SH; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 02.03.2026; Përgjigjen në ankesë të datës 05.03.2026, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura nga organi i punësimit; Vendim me numër protokoli Nr.AKF/2013; Formulari i përshkrimit të punës;

Kolegji i Këshillit, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se meqenëse nuk është nxjerr akt administrativ nga personi kompetent të cilit ankuesja edhe i është drejtuar me kërkesë, atëherë ekziston baza ligjore që të detyrohet Kryeshefi Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Forenzik, të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës të datës 12.01.2026, parashtruar nga ankuesja, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesja sipas vendimit nën shenjen AKF/2013 të datës 29.10.2013 është e punësuar pranë Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, dhe mbanë pozitën e punës Ekspert i Forenzikes.

Ankuesja, duke u bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese me numër KO79/23, Ligjin 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, Udhëzimin Administrativ me Nr.35/2012-MPB për Procedurat dhe Kriteret e Vlerësimit dhe Notimit të Punës së Punonjësve të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, Rregulloren me Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, Rregulloren (QRK) Nr.26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, Udhëzimin Administrativ me Nr.32/2012 për Pagat, Shtesat dhe Dobitë Tjera të Punonjësve në AKF-ë dhe Vlerësimet e punës nga viti 2011, përmes kërkesës me numër reference AKF/2026-003 të datës 12.01.2026, i është drejtuar Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, përmes së cilave kanë kërkuar nga organi i punësimit: I. rritjen e pagës bazë në masën 0.5% për vit të përvojës së punës, II. shpërblimin e 50% të pagës së rregullt mujore për çdo vit të vlerësimit të punës, III. pagesën e rrezikshmërisë në vlerë 170.00 Euro në muaj si dhe IV. pagesën e shujtës në vlerë 66.00 Euro në muaj, ndërsa, duke kërkuar sipas pikës V, që punëdhënësi të bëjë kompensimin retroaktiv të pagës nga pika I, III dhe IV nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa, të bëjë kompensimin retroaktiv të pagës nga pika II nga hyrja në fuqi e Ligjit 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.

Si rrjedhojë, Udhëheqësi i Divizionit për Financa dhe SHP në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, përmes Përgjigjes me numër AKF/2026-013, të datës 28.01.2026, pikë I të kërkesës së ankueses për rritjen e pagës bazë në masën 0.5% në mungesë të bazës ligjore e ka refuzuar, ndërsa lidhur me IV pikat tjera të kërkesave, ka njoftuar se DFSHP nuk ka kompetencë lëndore për trajtimin e çështjes në fjalë.

Ankuesja kundër përgjigjes së datës 25.02.2026, ka parashtruar ankesë në Këshill, me pretendim se është bërë, vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike dhe shkeljes së dispozitave materiale, e në mbështetje të Aktgjyqimit të Gjykatës Kushtetuese me numër KO79/23, Ligjin 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, Udhëzimin Administrativ me Nr.35/2012-MPB për Procedurat dhe Kriteret e Vlerësimit dhe Notimit të Punës së Punonjësve të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, Rregulloren me Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, Rregulloren (QRK) Nr.26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, Udhëzimin Administrativ me Nr.32/2012 për Pagat, Shtesat dhe Dobitë Tjera të Punonjësve në AKF-ë dhe Vlerësimet e punës nga viti 2011, Vendimin A.nr.1228/2024, kërkojnë nga Këshilli, I. aprovimin e ankesës në tërësi si të bazuar; II. Detyrimin e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë: të bëjë rritjen e pagës bazë në masën 0.5% për vit të përvojës së punës, të jap si shpërblim 50% të pagës së rregullt mujore për çdo vit të vlerësimit të punës, të bëjë pagesën e rrezikshmërisë në vlerë 170.00 Euro në muaj dhe të bëjë pagesën e shujtës në vlerë 66.00 Euro në muaj; si dhe III. Detyrimin e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë që mënyrë retroaktive të kompensoj: rritjen e pagës bazë në masën 0.5% për vit të përvojës së punës nga hyrja në fuqi e Aktgjyqimit të Gjykatës Kushtetuese, nr. KO79/23 deri në ekzekutimin e këtij vendimi, në formë shpërblimi 50 % të pagës së rregullt mujore për çdo vit të vlerësimit të punës nga hyrja në fuqi e Ligjit 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë deri në ekzekutimin e këtij vendimi; të bëjë pagesën e rrezikshmërisë në vlerë 170.00 euro në muaj dhe pagesën e shujtës në vlerë 66.00 euro në muaj nga hyrja në fuqi të Ligjit Nr.08/L-276 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve të Veçanta për Krijimin e Bazës Ligjore për Nxjerrjen e Akteve Nënligjore nga Qeveria dhe Ministria, të nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses dhe konstatimit të ligjshmërisë së aktit të kontestuar nga ankuesja, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat ligjore respektivisht nenin 52, paragrafi 1, nen paragrafi,1.3,1.4,1.5, dhe 1.7, të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: 1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë;1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në kuadrin ligjor të cekur si më lartë, lidhur me obligimin e organit përkatës për të vendosur lidhur me kërkesën e palës, e obligon Kryeshefin Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, që të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës të parashtruara nga pala ankuese të përfshira në këtë vendim, në atë mënyrë që gjatë shqyrtimit të kërkesës të shqyrtohen të gjitha pretendimet e palës ankueses dhe të vendoset për të gjitha pretendimet në fjalë në kuptim të nenit 48 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

***Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA, A.NR.205/2026

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses V.Sh;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Kosovës për Forenzik; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.